



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-32/19-06

Prishtinë, më 14 shtator 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën në fillim e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 90 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 31 gushtit 2006,
3. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për punën njëvjeçare 2005,
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, pas përfundimit të projektit të trajnimit për marrjen e kompetencave të kontrollit parlamentar të fushës së sigurisë,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Panelit të veçantë lidhur me mocionin në Ligjin për përdorimin e gjuhëve ,
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Legjislativ për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi të hiqet nga rendi i ditës pika e gjashtë, ngase deputetëve materiali u ishte shpërndarë me vonesë.

Ai kërkoi të formohet një komision hetimor i Kuvendit për të hetuar disa pjesëtarë të SHPK-së për sjelljet e tyre gjatë arrestimit të anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosja.

**Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoi që nga rendi i ditës së kësaj seance të hiqet pika e tretë. Raporti i ART-së duhet të plotësohet dhe të procedohet në Kuvend për shqyrtim.

**Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së i mbështeti kërkesat e dy parafolësve të saj për heqjen e dy pikave nga rendi i ditës, kurse kërkesa për formimin komisionit hetimor parlamentar tha se duhet të procedohet me shkrim.

**Teutë Sahatçiu**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s tha se kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së për formimin e komisionit hetimor parlamentar të shtyhet për seancën e radhës, ngase nuk ka informata të mjaftueshme për këtë çështje.

Ajo e mbështeti kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së që raporti i ART-së të plotësohet me të dhëna shtesë.

**Gjergj Dedaj**, (PLK) propozoi të shtyhet seanca e sotme.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për heqjen e pikës së gjashtë nga rendi i ditës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----84;

Kundër----- 3.

**Kryetari konstatoi:** shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve shtyhet për seancën e radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për heqjen e pikës së tretë nga rendi i ditës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 10.

**Kryetari konstatoi:** shqyrtimi i raportit të ART-së për punën njëvjeçare të plotësohet me të dhëna shtesë dhe t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim.

## 2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 31 gushtit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 31 gushtit 2006 u miratua pa vërejtje.

## 3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, pas përfundimit të projektit të trajnimit për marrjen e kompetencave të kontrollit parlamentar në fushën e sigurisë

---

**Kryetari** e ftoi kryesuesin e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

**Naim Maloku**, kryesues i Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë, tha se me formimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me bartjen e përgjegjësi të fushës së sigurisë nga institucioneve ndërkombëtare tek ato vendore, me ngritjen e kapaciteteve të ekzekutivit, për të cilat hollësisht i informoi deputetët, komisioni kishte zhvilluar një varg trajnimesh për aftësimin e tyre për ushtrimin e kontrollit parlamentar të fushës së sigurisë.

Në vazhdim deputeti Maloku foli për punën e deritanishme të Komisionit, që fushëveprim e kishte pasur kontrollin dhe mbikëqyrjen e Departamentit për Gatishmëri dhe Emergjencë, që deri më tani ka funksionuar në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Duke pasur parasysh ngritjen e kapaciteteve të ekzekutivit në fushën e sigurisë, shtrohet nevoja për mbikëqyrje parlamentare të kësaj fushe, prandaj ne propozojmë që Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë të riemërohet në Komision për Siguri në Kuvendin e Kosovës, si dhe të miratohet shtojca nr. 6 dhe t'i bashkëngjitet Rregullores së punës së Kuvendit për fushëveprimin e këtij komisioni.

Kryetari hapi debatin parlamentar lidhur me këtë çështje.

Deputetët: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Syla, Husnija Beshkoviq dhe Ylber Hysa** në diskutimet e tyre mbështetën raportin dhe propozimin e Komisionit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----77;  
Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

### V E N D I M

1. Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë riemërohet në Komision për Siguri i Kuvendit të Kosovës.
2. Miratohet shtojca nr. 6-të e raportit për fushëveprimin e Komisionit për Siguri dhe i bashkëngjitet Rregullores së Punës së Kuvendit.

#### **4. Shqyrtimi i rekomandimit të panelit të veçantë lidhur me mocionin në Ligjin për përdorimin e gjuhëve**

**Kryetari** i informoi deputetët për procedurën e shqyrtimit dhe të miratimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve më 27 korrik 2006. Por, Grupi Parlamentar 6+, i përfaqësuar nga deputeti Mahir Yagcilar, kishte ushtruar mocion për cenimin e të drejtave të komunitetit. Në përputhje me rregullat e procedurës ishte formuar paneli treanëtarësh për të shqyrtuar mocionin. Paneli njëzëri ka vendosur për rekomandimin lidhur me amendamentimin e nenit 2.3 të ligjit në fjalë.

Kryetari hapi debatin lidhur me rekomandimin e panelit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me rekomandimin e panelit dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Syla, Ferid Agani, Sabri Hamiti, Nazim jashari, Xhevat Bislimi, Fadil Kryeziu, Ymer Halimi dhe Kamber Kamberi**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Kryetari e hodhi në votim rekomandimin e panelit të veçantë për amendamentimin e nenit 2.3 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----37;  
Kundër----- 48.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash nuk e miratoi rekomandimin e panelit të veçantë për amendamentimin e nenit 2.3 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

**Kryetari** seancën e deklaroi të mbyllur në orën 11:25 minuta

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Sektori për Çështje Plenare dhe Procedurale**